



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2023:226007

Datë: 08.02.2024

Numri i dokumentit: 05301998

2023:262294

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK, Departamenti I Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me sekretaren juridike Indira Beqa, në çeshtjen penale ndaj të pandehurit B.Sh nga fsh. ..Komuna Kaçanik, i akuzuar për veprën penale, Shpërdorim i pasurisë së huaj nga neni 318 par.5 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.1173/23 të datës 17.11.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt.31.01.2024, në prezencë të prokurores së shtetit, Mimoza Sylja-Hyseni dhe të pandehurit, në mungesë të përfaqësuseit të të dëmtuarës, me dt.02.02.2024 mori dhe shpalli, ndërsa me dt.07.02.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri B.Sh nga fsh. ..., Komuna Kaçanik, i lindur më dt... , nga i ati I...dhe e ëma Nurije , e gjinisë H..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar,prind i tre fëmijëve, ka të kryer shkollës fillore, i vetëpunësuar në "...", i gjendjes së mesme ekonomike, me nr.personal:..

ËSHTË FAJTOR

Sepse me dt. 10 Gusht 2023 rreth orës 10:30 min, në Parkun Kombëtar “Sharri”, njësia menagjuese “Ahishta”, në vendin e quajtur “Rrafshi i Bujevës”, zona kadastrale Kaçanik , i pandehuri me qëllim të përvetësimit të pasurisë së luajtshme e që vetit t’i sjell dobi pasurore të kundërligjshme, ka përvetësuar pasurinë që e ka gjetur, në atë mënyrë që shkon tek vendi i lartpërmendur dhe pasi që vëren disa trungje të prera në vëllim prej 1.20 m³ , i shkurton të njëjtat dhe i ngarkon në një mjet transportues (kamionetë), dhe gjatë rrugës për në shtëpi, vërehet nga roja e pyllit dhe ndalet, ndërsa Drejtorisë për Adminstrimin e Parkut Kombëtar i ka shkaktuar dëm material në vlerë mbi 50€.

Me këtë veprim, i pandehuri ka kryer veprën penale, Shpërdorim i pasurisë së huaj nga neni 318 par.5 të KPRK-së.

Prandaj gjykata, në bazë të nenit 2,7,38,43,48,69,70,71 par.1 nënpar.1.3 të KPRK-së, dhe nenit 358,359,360 dhe 364 të KPP-së, e

G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumë prej 150.00 € (njëqind e pesëdhjetë euro) dhe me dënim me kusht me të cilin i vërtetohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 60 ditësh, i cili nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej një viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk do të kryej vepër tjetër penale, në të kundërtën do t’i revokohet dënimi me kusht.

I pandehuri është i obliguar që dënimin me gjobë t’a paguajë ne afatin prej 30 ditesh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën, gjykata do t’a zevendesojë dënimin me gjobë me dënim me burgim duke llogaritur shumën prej 20 € për çdo ditë burgimi.

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor, të paguajë pranë kësaj gjykate, shumën prej 30.00€, ndërsa për Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumën prej 20.00€, në afat të njëjtë me gjobën, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

E dëmtuara, DAPK “Sharri”Prizren, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Konfor nenit 92 par.1 të KPRK-së dhe nenit 269 par.1 të KPPK-së, të pandehurit i konfiskohet, masa drusore në vëllim të përgjithshëm prej 1.20 m3.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.1173/23 të datës 17.11.2023 të pandehurin B.Sh nga fsh...-Kaçanik, e ka akuzuar për veprën penale, Shpërdorim i pasurisë së huaj nga neni 318 par.5 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që I njëjti të shpallet fajtor dhe të gjykohet sipas ligjit.

Në bazë të kësaj aktakuze, gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar me dt.31.01.2024 me të cilin rast, prokurorja e shtetit Mimoza Sylja-Hyseni, mbeti në tërësi pranë aktakuzës të parashtruar pranë kësaj gjykate, pa ndryshime dhe plotësime.

I pandehuri ne fjalën e tij ne pyetjen e gjyqtares e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon akuza, dhe shton se e ndien veten të penduar për veprimin e tij, të cilin premtion se nuk do t’a përsërisë në të ardhmen, meqë edhe ashtu nuk ka kohë sepse merret me punët në biznesin e tij, prandaj edhe kërkon nga gjykata që, duke qenë se është hera e pare që ka rënë në kundërshtim me ligjin, me rastin e marrjes së vendimit t’I shqiptohet një denim sa më I ulët që të jetë e mundur.

Prokurorja e shtetit ne fjalën e saj, pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, i akuzuar për veprën penale, Shpërdorim i pasurisë së huaj nga neni 318 par.5 të KPRK-së, pasi që një pranim i tillë u bë vullnetarisht nga ana e të pandehurit si dhe është në përputhje me dispozitën e nenit 242 të KPP-së, andaj i propozon gjykatës që të bëjë pranimin e fajësisë për të pandehurin dhe t’i shqiptojë sanksion penal sipas ligjit.

Gjykata ka konstatuar se janë përmbushur kushtet nga neni 242 të KPP-së, pasi që formoi bindjen se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i

fajesise është bërë vullnetarisht, se pranimi i fajit mbeshtetet ne faktet e çeshtjes qe permban akuza, se akti akuzues nuk permban asnje shkelje te qarte ligjore apo gabime teknike, prandaj edhe pranoi pranimin e fajësië për të pandehurin.

Nisur nga kjo gjendje e vërtetuar në procedurë gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale, Shpërdorim i pasurisë së huaj nga neni 318 par.5 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit te dënimit gjykata pati parasysh te gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 70 të KPRK-së, kështu që si rrethanë lehtësuese gjykata mori faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza në seancën e shqyrtimit fillestar, duke shprehur pendesë për veprimin e tij, dhe duke i premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla, pastaj faktin se, bazuar në evidencën e kësaj gjykate, I njejt i nuk evidentohet për ndonjë vepër tjetër penale, ndërsa rrethanë të posaçme rënduese gjykata nuk gjeti, përveq veprimeve të të pandehurit të cilat paraqesin elemente të veprës penale, për të cilën shpallur fajtor,

Andaj gjykata, për këto arsye të pandehurin B.Sh, i akuzuar për veprën penale, Shpërdorim i pasurisë së huaj nga neni 318 par.5 të KPRK-së, e gjykoi me dënim si në dispozitiv, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është ne proporcion me veprën si dhe sjelljen e te pandehurit, dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit te vlerave te mbrojtura, personalitetin e te pandehurit, andaj edhe konsideron se ky dënim do të ndikojë pozitivisht tek i pandehuri dhe personat tjerë qe të mos kryejnë vepra te tilla penale duke ngritur vetëdijësimin per respektimin e ligjit dhe se me ketë do të arrihet ne tërësi qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 te KPRK-së.

Gjykata, bazuar në nenin 92 par.1 të KPRK-së dhe nenin 269 par.1 të KPPK-së, të pandehurit i konfiskon masën drusore në vëllim të përgjithshëm prej 1.20m³, meqë gjatë seancës së shqyrtimit fillestar u vërtetua se këto të fundit, përbëjnë dobi pasurore të përfutur me vepër penale.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për kërkesën pasurore juridike, është i bazuar në dispozitën e nenit 462 të KPP-së.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

2023: 255248 datë 07.02.2024

Sekretarja Juridike,

Indira Beqa

Gjyqtarja,

Zajrete Muhaxheri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.